

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION

Nr. i Prot. 7609
 Broj Prot. 7609
 Prot. No. 7609

Data: 11.07.19
 Datum: 11.07.19
 Date: 11.07.19

PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transportation

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 478/19
 Broj Prot. 478/19
 Prot. No. 478/19

Data: 11.07.19
 Datum: 11.07.19
 Date: 11.07.19

PRISHTINË/A

KM-MIT
 2+slit

Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, në mbështetje të nenit 145 (paragrafit 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe neni 38 (paragrafi 3) të rregullores nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave (22.03.2011), Rregulloren nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.02/2011 Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave, nenit 84 dhe 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazta Zyrtare Nr. 20/21 Qershor 2016), nenit 5 dhe 21 Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, Udhëzimin Administrativ nr. 06/2016 për plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendit të Udhëtimit të Transportit Ndërrurban të Udhëtarëve me Autobus, Udhëzimin Administrativ nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendit të udhëtimit të transportit ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit të caktuar me vendimin nr. 5517 të dt.23.05.2019, nxjerr këtë:

VENDIM

Refuzohet ankesa nr. prot. 4823 të dt. 07.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues N.T.P. "VAIDI" nga Ferizaj, ndaj vendimit nr.4153 të dt.19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Viti - Kllokot - Pozhoran - Prishtinë (nëpër autostradën Arbër Xhaferi), për nisje në ora 06:30 me kthim në ora 09:35, për nisje në ora 10:00 me kthim në ora 15:10, për nisje në ora 13:00 me kthim në ora 16:35 dhe për nisje në ora 14:00 me kthim në ora 18:10.

Arsyetim

Komisionit i emëruar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, me vendimin nr. prot. 5517 të datës: 23.05.2019, pas shqyrtimit të ankesës nr. prot. 4823 të dt. 07.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues N.T.P. "VAIDI" nga Ferizaj, ndaj vendimit nr.4153 të dt.19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Viti-Kllokot-Pozhoran-Prishtinë (nëpër autostradën Arbër Xhaferi), për nisje në ora 06:30 me kthim në ora 09:35, për nisje në ora 10:00 me kthim në ora 15:10, për nisje në ora 13:00 me kthim në ora 16:35 dhe për nisje në ora 14:00 me kthim në ora 18:10, dhe pas vlerësimit të dosjes të aplikimit, kushteve për aplikim në shpalljen publike dhe procesverbalit nr.2151 të dt.11.03.2019 të komisionit të caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit me vendimin nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019 për vlerësimin e aplikacionit, ka konstatuar se komisioni i caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit

me vendimin nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019, vlerësojmë se komisioni ka bërë vlerësim të drejtë të aplikacionit , kështu që operatori në fjalë nuk i ka plotësuar kushtet sipas pikës (4) të shpalljes publike nr.1643 dt. 21.02.2019 dhe paragrafit (1) nën paragrafi 1.8 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe Rendin e Udhëtimit të Transportit Ndërrurban të Udhëtarëve me Autobus i cili kriter është dhënë edhe në shpjegimin për mënyrën e aplikimit në shpalljen publike nr.1643 dt. 21.02.2019, pasi që i njëjti në dosje të aplikimit ka prezantuar rendin e udhëtimit ku forma, vende ndaljet dhe përmbajtja në rendin e udhëtimit nuk janë të formatit të kërkuar, si dhe ka prezantuar rendet e udhëtimit me përmbajtte të gabuar.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroi pari në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Zyrës së Arkivit të MI -së.

